

VENDIM
Nr.203, datë 19.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR MILOT-RRËSHEN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “ Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.11.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme (objekte), që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objektet, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 17 449 088 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e nëntë mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
 5. Shpronësimi të fillojë më 28.2.2009 dhe të përfundojë më 30.4.2009.
 6. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afateve, të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi.
 7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E OBJEKTEVE NË PRONËSI PRIVATE QË PREKEN NGA
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR MILOT-RRËSHEN

Nr.	Lloji i objektit	Emri i pronarit	Nr. pasurisë	Segmenti	Vlera lekë
1	Shtëpi 1-kt	Franc Preng Jaku	3/40	Milot-Rrëshen	2 332 942
2	Servis	Gjin Pjetër Çerri	45/45	Milot-Rrëshen	207 544
3	Servis	Ndue Jaku		Milot-Rrëshen	418 957
4	Shtëpi 3-kt	Pjetër Ndue Preçi	3/20	Milot-Rrëshen	4 155 307
5	Shtëpi 1-kt	Ded Shan Kola	1/104	Milot-Rrëshen	3 215 162
6	Banesë	Ismet Veseli		Milot-Rrëshen	164 719
7	Shtëpi 1-kt	Adem Xhafer Lika	40/16/1	Milot-Rrëshen	835 406
8	Shtëpi 2-kt + shesh prodhimi	Vlash Ded Gega	1/46, 1/82	Milot-Rrëshen	5 006 345
9	Bar-bufë	Ndue Nikoll Zambaku		Milot-Rrëshen	731 565
10	Shtëpi 1-kt	Lek Nikoll Fusha		Milot-Rrëshen	381 141
		TOTALI			17 449 088